



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proçes verbal

Sot me datë 30.10.2024 ora 14:00 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Të pranishëm janë:

Z. Oltion Luli

Znj. Irena Shala

Znj. Valjeta Bajraktari

Z. Gjergj Sokoli

Mungon:

Z. Blendi Gjylbegaj

Z. Edmond Ndou

Znj. Violeta Perndrecaj

Vijohet me citimin e rendin të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Diskutohet mbi pikat e parashikuara të rendit të ditës, për të cilat të pranishmit bien të gjithë dakort dhe me 4 vota Pro miratohet. Diskutohet dhe bihet në dakortësi, që mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak do të mbahet të mërkurën datë 06.11.2024 ora 17:00 me rend dite si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2024"*.
2. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55, datë 29.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashisë Shkodër" të ndryshuar.*
3. Pr/ Vendim: *"Për caktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe në sheshe, në territorin e Bashkisë Shkodër"*.
4. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim në VKB Nr.8 datë 31.01.2024, Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e Bashkisë Shkodër për "Projektin Hold On- nxitja e aksesit në mbështetjen e shëndetit mendor për të rinjtë"*.
5. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim dhe shtesë në VKB Nr.5 dt:05.01.2022 "Për miratimin e rrjetit të linjave dhe tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve për periudhën afatmesme 2022-2024 në Bashkinë Shkodër"*



6. Pr/ Vendim: "Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për vendosjen e veprave të artit publik, në territorin e Bashkisë Shkodër".

7. Pr/ Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.18 date 20.07.2024 "Për miratimin e dhënies me qira/përdorim të sipërfaqes 0.320 ha në Ekonominë Pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A.Gur i Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse, aerogjeneratorë për një periudhë 12 muaj për shoqërinë "Volitalia ALBANIE"


8. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Pas diskutimeve për rendin e ditës Z.Luli vë në dijeni anëtarët e Kryesisë, se Znj.Marina Duhani me ndërmjetësimin e Konsullit të Nderit Z.Dodani, ka mundësuar një vizitë pune me Këshillin Komunal të San Giorgio a Cremano, Napoli për një mundësi binjakëzimi në të ardhmen. Ai shton se buxheti i Këshillit Bashkiak është i limituar për të gjithë anëtarët e Këshillit. Për më tepër që objekti i këtij takimi është mundësia e binjakëzimit ndërmjet dy këshillave dhe ai mendon se përfaqësuese duhet të jetë kryesia e vetë Këshillit. Kryesia vendos që për efekt buxheti të limituar dhe objektit të kësaj vizite Këshilli bashkiak duhet të përfaqësohet nga anëtarët e Kryesisë, meqënëse kështu përfaqësohen të gjitha grupet politike. Po ashtu pjesë e vizitës do jetë edhe Znj.Duhani si ndërmjetësuese e takimit dhe sekretariati i Këshillit.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka, mbledhja deklarohet e mbyllur.

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti



SEKRETAR

Sabina DANAJ

